



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VIII**  
**Sesioni vjeshtor**

---

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë  
Mbledhja nr. 97  
Prishtinë, më 15.11.2024, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Arbëreshë Kryeziu Hyseni, Adelina Grainca, Yllza Hoti, Gazmend Gjyshinca, Fitore Pacolli-Dalipi, Time Kadrijaj dhe Bahrim Shabani.

**Munguan:** Xhavit Haliti, Ariana Musliu-Shoshi dhe Doarsa Kica-Xhelili.

**Nga Zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Adriana Osmani, Kuvend.

**Takimin e kryesoi:** Arbëreshë Kryeziu Hyseni, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 16 e 24 shtator, 9 tetor dhe 11 nëntor 2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, lidhur me fushën në fushëveprim të Komisionit;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetarja konstatoi se komisioni e miratoi rendin e ditës.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 16 e 24 shtator, 9 tetor dhe 11 nëntor 2024;**

Kryetarja konstatoi se komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 16 e 24 shtator, 9 tetor dhe 11 nëntor 2024 3.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, lidhur me fushën në fushëveprim të Komisionit;**

**Arbëreshë Kryeziu Hyseni**, theksoi se sipas nenit 80 paragrafit 3 të Rregullores së Kuvendit, pas miratimit në shqyrtim të parë, Projektligji mbi ndarjet buxhetore shqyrtohet nga komisioni përgjegjës-raportues dhe komisionet e tjera parlamentare nga fushëveprimi i tyre. Për shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, tha se komisioni është ngarkuar me Vendim të Kuvendit që ta shqyrtoj projektligjin, me ç'rast edhe është ftuar kjo mbledhje e komisionit.

Pas diskutimeve lidhur me Projektligjin nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në fushëveprim të komisionit kryetarja konstatoi se, komisioni nxori këtë:

#### **Përfundim**

Në Projektligjin nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 në fushëveprim të Komisionit, nuk ka rekomandime e as amendamente, nga ana e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:20.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

Arbëreshë Kryeziu Hyseni

---

Kryetare e Komisionit